

MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRIA E BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E POLICISË SË SHETIT

AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 1157/Prot., datë 22.12.2023  
1

Nr. 6200 Prot., datë 12.12.2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT**

**DHE**

**AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT**

**“PËR RUAJTJEN DHE RRRITJEN E SIGURISË SË JETËS DHE SHËNDETIT TË  
KONSUMATORIT”**

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)**, si autoriteti që me veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit, ka për mision garantimin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, inpleteve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij, nëpërmjet kryerjes së veprimtarive inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë. përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Z. Edmond Rrushi**, që këtu më poshtë referuar si "Palë", dhe,

**Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH)**, si institucioni që me veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit, ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike dhe garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njëriut, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm **Drejtues Madhor Muhamet Rrumbullaku**, që këtu me poshtë referuar si "Palë",

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit për ruajtjen dhe rritjen e sigurisë së jetës dhe shëndetit të konsumatorit,

Duke marrë në konsideratë bashkëpunimin e deritanishëm, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë

së Shtetit, DPPSH dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, AKU, më poshtë të quajtura "Palët", bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi, me përmbajtje si vijon:

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që të nxisë bashkëpunimin ndërinstytucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për bashkërendimin e veprimeve për forcimin e shtetit ligjor dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të konsumatorëve, si dhe parandalimin dhe goditjen e kriminalitetit në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë, inputeve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij.

## **Neni 2 Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshjeje është rritja e bashkëpunimit për:

1. Mbështetjen e inspektimeve të strukturave të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në rastet e rezistencës fizike, apo pengimit në kryerjen e detyrave nga subjekte apo individë të ndryshëm;
2. Identifikimin dhe goditjen e individëve e grupeve kriminale të përfshira në aktivitetin e paligjshëm të prodhimit, trafikimit, importimit/eksportimit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, inputeve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij në standardet e lejuara/miratuara;
3. Grumbullimin, shkëmbimin, vlerësimin dhe analizimin e informacioneve me qëllim identifikimin e personave të përfshirë në këto aktivitete kriminale, si dhe identifikimin e linjave, mjeteve, formave dhe vendeve të kryerjes së tyre;
4. Përmirësimin e kapaciteteve në drejtim të dokumentimit të aktiviteteve kriminale;
5. Koordinimin e veprimeve operative e hetimore që lidhen me identifikimin dhe goditjen e personave të dyshuar për importimin, prodhimin, shitjen dhe ruajtjen e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve apo vendosjen në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër të ushqimeve ose futjes në prodhimin e artikujve ushqimore e kimikateve, materialeve apo lëndëve shtesë, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve;
6. Identifikimin dhe goditjen e mashtrimit me produktet ushqimore lidhur me importimin, prodhimin, ruajtjen, ofrimin për shitje, falsifikimin, shitjen apo vendosjen në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër të ushqimeve, materialeve ose lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimore, në të cilët janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rremë në etiketimin e produkteve ushqimore, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve;
7. Identifikimin dhe referimin e rasteve të prishjes me dashje të shenjave të sigurisë, të

vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikëqyrjeje, kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit;

8. Ndhmën e ndërsjellë për shkëmbimin e informacionit dhe dokumentimin sa më mirë të punës së AKU dhe DPPSH për forcimin e luftës kundër veprimtarive të paligjshme në fushën e ushqimit, ushqimit për kafshë, inuteve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij.

### **Neni 3 Baza Ligjore**

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;

Ligji 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar;

Ligji 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", i ndryshuar;

Ligji 105/2016 "Për Mbrojtjen e Bimëve";

Ligji 10390, datë 03.03.2011 "Për Plehrat e Përdorimit për Bimësinë", i ndryshuar;

Ligji 10416 date 07.04.2011 "Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor", i ndryshuar;

Ligji 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

### **Neni 4 Rolet dhe përgjegjësitë e palëve**

AKU dhe DPPSH bien dakord me këtë Marrëveshje:

1. Për kryerjen e veprimeve të përbashkëta të strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë me strukturat e drejtorive rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në rastet e rezistencës fizike apo pengimit të strukturave të AKU nga subjekte apo individë të ndryshëm;
2. Identifikimin e individëve, personave fizikë, juridikë apo grupeve kriminale që zhvillojnë në mënyrë të jashtëligjshme aktivitetin e trafikimit, prodhimit, importimit/eksportimit, tregtimit, magazinimit nën standardet e miratuara/lejuara të produkteve ushqimit, ushqimit për kafshë, inuteve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij;
3. Sekuestrimin e ushqimit, ushqimit për kafshë, inuteve bujqësore, duhanit dhe produkteve të tij nën standardet e lejuara/miratuara apo të falsifikuar si dhe të pajisjeve, lëndës së parë apo mjeteve që përdoren për prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shkatërrimi i tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
4. Përmirësimin e bashkëpunimit praktik ndërmjet strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë së Shtetit dhe strukturave të drejtorive rajonale të AKU-së, për parandalimin e

trafikimit/kontrabandimit apo deklarimeve të rreme nën standardet e lejuara/miratuara me destinacion tregun shqiptar;

5. Koordinimin e veprimeve për inspektime të përbashkëta bazuar në informacionet e të dhënat që disponojnë dhe sigurojnë strukturat e policisë në Drejtoritë Vendore të Policisë së Shtetit, që orientohen në verifikimin e të gjithë territorit të Qarkut, të individëve kriminalë, grupeve kriminale apo subjekteve (personave fizikë/juridikë) që prodhojnë, falsifikojnë, importojnë/eksportojnë, tregtojnë, transportojnë apo magazinojnë ushqim, ushqim për kafshë, inpleteve bujqesore, duhanit dhe produkteve të tj;

6. Koordinimit të veprimeve operative e hetimore të strukturave të Hetimit të Krimit Ekonomik e Financiar me strukturën e Hetimit Ushqimor dhe Monitorimit të AKU për të kryer kontrole të përbashkëta në subjektet tregtare, për identifikimin dhe sekuestrimin e provave materiale të rrjedhura nga krimi, sipas parashikimeve të nenit 288 dhe 288/a, 288/c dhe 288/ç të Kodit Penal, duke treguar kujdes të veçantë me vlerësimin dhe ruajtjen e provave materiale, që për shkak të natyrës së tyre mund të prishen apo të humbasin cilësitë ekzaminuese, si dhe ruajtjes së tyre.

#### **Neni 5 Kërkesat e Raportimit**

Sipas metodologjisë së sipërpërmendur, përditësimet e ecurisë ndërmjet AKU dhe DPPSH, mund të kryhen si vijon:

1. Zbatimi i neneve 2 dhe 3, të kësaj Marrëveshje do të mundësohet nëpërmjet informacionit që do të shkëmbehet nga të gjitha njësitë e varësisë të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe strukturave respektive të varësisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, referuar kompetencave territoriale;
2. Rregulli i përgjithshëm i dhënies së informacioneve është ai shkresor dhe elektronik;
3. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra tjetrën, me qëllim rakordimin e veprimeve që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

#### **Neni 6 Dispozitat e fundit**

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Palët përkatëse dhe nënshkruhet pa afat;
2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet me mirëkuptim midis Palëve;
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.
4. Kjo Marrëveshje bëhet e ditur të gjitha njësitë të varësisë të palëve, me qëllim marrjen e masave për zbatimin me sukses të saj;
5. Marrëveshja e Bashkëpunimit hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4

(kater) kopje origjinale me të njëjtën vlerë ligjore, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe dy të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

6. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua, sot më datë, 12 / 12 . 2023

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E POLICISË SË SHETIT**

**AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**DREJTUES MADHOR  
MUHAMET RRUMBULLAKU**

**EDMOND RRUSHI**

